



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 02 datë 30.03.2026

**PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT  
PËR OBJEKTIN: "ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS AEROPORTUALE  
BRENDA TERRITORIT TË AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS", ME  
VENDNDODHJE NË BASHKINË KRUIJË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Tirana International Airport" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit për objektin: "Zgjerimi i infrastrukturës aeroportuale brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës", me vendndodhje në Bashkinë Krujë, me zhvillues subjekt shoqërinë "Tirana International Airport" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 06, datë 08.03.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.
4. Vendimi Nr. 5, datë 18.04.2025 i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin: "Zgjerimi i Infrastrukturës Aeroportuale, Faza 1, brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës", me vendndodhje në Bashkinë Krujë, me subjekt zhvillues "Tirana International Airport" sh.p.k, shfuqizohet.



5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKACI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12 /05/ 2026